



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 49, datë 27.03.2019

PËR

NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 47, DATË 18.03.2019 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, mbi kërkesën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të regjistruar pranë Këshillit me aktin nr. 1798 prot., datë 25.03.2019,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 6 “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë”, paragrafi I, të Vendimit Nr.47, datë 18.03.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë:

“Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, {....} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen penale me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; të pandehur: {....}, {....},{....}; akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/3 i Kodit Penal {....} dhe “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal {....} dhe {....}”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR

KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR